



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion

Mbledhja nr. 05/2009
Më 19.02.2009, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

Procesverbal

Në mbledhje morën pjesë: Myzejene Selmani - kryetare e Komisionit, Ethem Çeku, Haki Shatri, Safete Hadergjonaj, Fatmir Rexhepi, Sala Berisha – Shala, Berim Ramosaj dhe Kaqusha Jashari.

Munguan: Slobodan Petroviq, Zef Morina dhe Mufëra Şinik.

Pjesëmarrës të tjerë: Bill Klawonn dhe Haxhi Gashi - USAID, Remzije Hajdari dhe Izer Arifi - MTI, Besim Zeqiri - ICO, Blerina Uka - NDI, Isuf Zejna - KDI, Lejla Selimi – OSBE dhe Lumnije Berisha - Presidenca.

Nga Zyra Mbështetëse: Hasan Tahiri, Advije Morina, Armend Ademaj dhe Besim Haliti.

Mbledhjen e drejtoi Myzejene Selmani - kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 10 .02. 2009;
3. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/17 për mbrojtjen e konsumatorëve;
4. Shqyrtimi i Projektligjit për rezervat shtetërore të mallrave;
5. Të ndryshme.

I. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

II. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 10. 02. 2009

Procesverbali i mbledhjes së 10 shkurtit 2009 u miratua pa vërejtje.

III. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/17 për mbrojtjen e konsumatorëve

Kryetarja – Theksoi se Grupi i Punës për shqyrtimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/17 për mbrojtjen e konsumatorëve, i kryesuar nga z. Berim Ramosaj, ka përgatitur raportin për këtë projektligj dhe e hapi diskutimin.

Pas debatit të gjerë Komisioni njëzëri e nxori këtë

Përfundim

- I. Miratohet raporti për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/17 për mbrojtjen e konsumatorëve;
- II. Autorizohet Njësia Mbështetëse e Komisionit ta procedojë raportin sipas rregullave procedurale.

IV. Shqyrtimi i Projektligjit për rezervat shtetërore të mallrave

Kryetarja – Kërkoj nga kryesuesja e Grupit të Punës për Projektligjin për rezervat shtetërore të mallrave, znj. Safete Hadergjonaj, ta njoftojë Komisionin për ecurinë e tij.

Safete Hadergjonaj – Njoftoi se është duke punuar në këtë projektligj dhe Grupi i Punës sapo të jetë gati, do ta ofrojë raportin me amendamente. Tha se paraprakisht duhet të konsultohet më udhëheqësit e grupeve të punës të projektligjeve, pastaj të caktohet rendi i ditës për shqyrtimin e projektligjeve.

V. Të ndryshme

V. a) Rekomandimi për Ministrinë e Tregtisë dhe të Industrisë për zbatimin e Marrëveshjes së CEFTA-s

Kryetarja – E paraqiti rekomandimin e Grupit të Punës për Ministrinë e Tregtisë dhe të Industrisë për zbatimin e Marrëveshjes së CEFTA-s dhe hapi debat.

Pas debatit të gjerë të deputetëve: Ethem Çeku, Berim Ramosaj, Kaqusha Jashari, Haki Shatri, Safete Hadergjonaj dhe Sala Berisha - Shala, Komisioni e nxori këtë

Rekomandim

- U rekomandohet Qeverisë së Kosovës dhe Ministrisë së Tregtisë dhe të Industrisë të ndërmarrin urgjentisht veprime të ndërsjella ndaj vendeve që nuk e respektojnë Marrëveshjen e CEFTA-s kundrejt Republikës së Kosovës.

Komisioni e nxori edhe këtë

Përfundim

- I. Ministria e Tregtisë dhe e Industrisë t'i japë Komisionit raport përmbledhës dhe material shtesë për zbatimin – mosrespektimin e Marrëveshjes së CEFTA –s nga disa vende.
- II. Mundësisht Raporti dhe materiali shtesë t'i ofrohen Komisionit brenda 10 (dhjetë) ditësh.

V.b) Organizimi i dëgjimit publik për Projektligjin për zonat ekonomike

Haki Shatri – Kryesues i Grupit të Punës, theksoi se me Njësinë Mbështetëse dhe me NDI-në janë bërë të gjitha përgatitjet për dëgjimin publik për Projektligjin për zonat ekonomike, që do të mbahet më 25. 02. 2008, në Hotel Grand, dhe i ftoi të gjithë anëtarët e Komisionit të marrin pjesë.

V. c) Çështje vijuese

Safete Hadergjonaj – Kërkoj që para miratimit të rendit të ditës të ceket cilat nënpika i ka rendi i ditës në të ndryshme, pastaj të miratohet rendi i ditës, sepse po debatohen disa çështje të rëndësishme që mund të vihen si pika të rendit të ditës.

Kryetarja – I njoftoi anëtarët e Komisionit që në mbledhjen e ardhshme në rend dite të jenë për diskutim këto çështje: shqyrtimi i Ligjit për shpronësim dhe shqyrtimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/45 për tregtinë me naftë dhe me derivate të naftës në Kosovë.

Mbledhja përfundoi në orën 11:45.

Kryetare e Komisionit

Myzejene Selmani